

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.368/25

Datë:11.06.2025

Duke u bazuar në Ligjin Nr.08/L-153 Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, Udhëzimit Administrativ Nr.03/2022 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, Drejtori Komunal i Arsimit në Istog ,shpall këtë:

K O N K U R S

PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE
PUBLIKE NË KOMUNËN E ISTOGUT PËR VITIN
2025/26

Drejtoria e Arsimit shpall konkurs për këto vende të lira në institucionet parashkollore publike në Komunën e Istogut.

Vendet e lira në Institucionet parashkollore 2025-2026

Grup-mosha	IP. Gzimi Ynë Istog	IP. Pëllumbat e Ardhmërisë Rakosh	IP. Lulet e Jetës Vrellë	IP. Ardhmëria Jonë Gurrakoc	IP. Shpresa Jonë Banië	Gjithsej
09 -> 2 vjet.	8			4	2	14
2-> 3 vjet.						0
3-> 4 vjet.		4	3			7
4-> 5 vjet.			8			8
5->6 vjet					2	2
Gjithsej	8	4	11	4	4	31

- Dokumentet e shërbimeve komunale, jo më të vjetra se gjashtë muajt krymës (Ujë dhe Mbeturinave)
- Për qiramarrësit – Kontratë e noterizuar mbi qiranë,
- Dëshmia nga mjeku për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të fëmijës;
- Dëshmia për vaksinimin e fëmijës (fletorja e shëndetit të fëmijës);
- Kontrata për marrëdhënien e punës për të dy prindërit (nëse prindërit janë në marrëdhënien e punës;
- Pasqyra e Trustit për gjashtë (6) mujorin e fundit;
- Dokumentet tjera të noterizuara për të dëshmuar kategorinë përkatëse janë të përcaktuara me vendimin 05.Nr.367/25 dt.11.06.2025

II. Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të fëmijëve në institucionet parashkollore

Regjistrimi i fëmijëve në IP do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parashkollor (Ligji Nr.08/L-153 Edikimin në Fëmijërinë e Hershme), në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr: 03/2022 për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë dhe në Vendimin e kriterëve të pranimit të fëmijëve në institucionet parashkollore publike të Drejtorisë Komunale të Arsimit.

Prindërit apo kujdestari ligjor për fëmijët e tyre mund të aplikojnë ne me shprehje se 1 institucion parashkollor por përparësi pranimi kane në institucionin me të afërt sipas zonës së jetesës.

III. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur nga data **12.06.2025** e deri më datën **26.06.2025**;
- Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra Nr.100, kati përdhes dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin përcjellës, po në të njëjtën zyre **çdo ditë pune prej orës 08:00 deri në ora 16:00**;

Vërejtje: Të gjitha dokumentacionet e pakompletuara dhe jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



Drejtori i DKA-së
Naim Behlulaj

Naim Behlulaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.367/25

Dt.11.06.2025

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L- 040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008), Ligjin Nr.08/L-153 Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, Ligjit Nr.04/L-32 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.03/2022 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Istog merr këtë:

VENDIM

PËR KRITERET E PRANIMIT TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE PUBLIKE NË KOMUNËN E ISTOGUT

1. Vetëm fëmijët e prindërve që janë banorë të Komunës së Istogut mundë të regjistrohen në institucionet parashkollore (IP), të Komunës së Istogut.
2. Planifikimin për numrin e fëmijëve që do të pranohen në IP e bëjnë vetë IP-të, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore të IP-ve.
3. Mosha minimale e fëmijëve dhe grup moshave që do të pranohen në IP e përcaktojnë vetë IP-të, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore të IP-ve, për llogaritja e moshës së fëmijëve nuk bëhet duke marr parasysh datën e aplikimit por datën e fillimit të shërbimit.
4. Pranimi i fëmijëve në IP bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat bazuar në kriteret e specifikuara në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Kategoria	
1	Fëmijët bonjakë pa të dy prindërit	100
2	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i punësuar	90
3	Fëmijët bonjakë pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i pa punësuar	80
4	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	40
5	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse njeri prind punon	30
6	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse asnjeri prind nuk punon	20
7	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse të dy prind punojnë	80
8	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse njeri prind punon	60
9	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse asnjeri prind nuk punon	40
10	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i punësuar	60
11	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i pa punësuar	30
12	Fëmijët e veteraneve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	20
13	Fëmijët e veteraneve të luftës së UÇK-së nëse njeri prind punon	15
14	Fëmijët e veteraneve të luftës së UÇK-së nëse asnjeri prind nuk punon	10
15	Prindërit e fëmijëve në asistencë sociale	20
16	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve deri në 350 euro)	40
17	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve 351-700 euro)	20
18	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore të prindërve 701-1000 euro)	15
19	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura mujore mbi 1000 euro)	10
20	Fëmijët e prindërve që janë banues në lagjen – Bashkësitë Lokale ku gjendet IP-ja	20
21	Fëmijët e punëtorëve të IP-së	20
22	Fëmijët e prindërve që tashme kane një fëmijë vijues në IP	10
23	Fëmijët që njeri prindërit ju punon (me të ardhura mujore të prindërve deri në 350 euro)	20
24	Fëmijët që njeri prindërit ju punon (me të ardhura mujore të prindërve 351-700 euro)	15
25	Fëmijët që njeri prindërit ju punon (me të ardhura mujore të prindërve 701-1000 euro)	10
26	Fëmijët që njeri prindërit ju punon (me të ardhura mujore mbi 1000 euro)	5

5.Të gjitha statuset e të gjitha kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmohen me dokumente valide të lëshuara nga institucionet relevante.

6 Ky vendim hynë në fuqi me njëherë

7.Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset ,Komisioni përzgjedhës , DKA-ja dhe një kopje në arkivin e këtij institucioni.



Dejtor i DKA-së
Naim Behlulaj

Naim Behlulaj